



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.121, datë 11.05.2021

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 436, SERIA TGN19, PËR AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR, DHËNË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 15, DATË 31.01.2019

Në mbështetje të nenit 4, pika 50, nenit 23, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 35, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, nenit 9, pika 2, gërma “a” dhe gërma “x”, nenit 9, pika 2, gërma “a”, xvii, si dhe nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 68/8 prot., datë, 07.05.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror,

Konstatoi se:

- Me vendimin nr. 15, datë 31.01.2019, bordi i ERE-s ka vendosur: Të licencojë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), si Degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG, për një afat 25 vjeçar, nga data e fillimit të operimit.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 596 prot., datë 15.04.2021, shoqëria Trans Adriatic Pipeline AG Albania (TAP AG ALBANIA) ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e kohëzgjatjes së Licencës së transmetimit të Gazit Natyror, nga 25 vjet deri në 30 vjet, duke e bazuar këtë kërkesë në nenin 23, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenin 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017.
- Shoqëria TAP AG ALBANIA shprehet se zgjatja e afatit të licencës së transmetimit nga 25 vjet deri në 30 vjet, do të siguronte harmonizimin e Licencës së transmetimit me lejen e veçantë të dhënë TAP-it me VKM nr. 123, datë 13.03.2019, duke theksuar se sipas nenit 5.2, të ligjit nr. 116/2013, datë 15.04.2013, *Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me*

Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, i ndryshuar, leja e veçantë rinovohet automatikisht nga Autoritetet Shqiptare, në përfundim të periudhës 30 vjeçare, më konkretisht më 21.03.2049. Gjithashtu, jetëgjatësia minimale operacionale teknike e sistemit të transmetimit të gazit natyror të TAP-it është 50 vjet.

- Në zbatim të nenit 23, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 102/2015 *Për sektorin e gazit natyror*, i ndryshuar, si dhe nenit 5, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, vlerësohet pranimi i kërkesës së shoqërisë TAP AG ALBANIA dhe fillimi i procedurës për modifikimin e licencës së saj për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, për sa i përket kohëzgjatjes, nga 25 vjet deri në 30 vjet, por duke mbajtur në konsideratë faktin se për 5 vitet e tjera (si referuar kërkesës së vetë subjektit) shoqëria nuk është subjekt i përjashtimit.
- Nga shqyrtimi i kësaj kërkesë rezulton se subjekti ka plotësuar kryesisht kërkesat e nenit 13, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror*”, si më poshtë:

Neni 13, pika 4:

- a. *Tekstin e propozuar të ndryshimit specifik që është kërkuar. **Plotësuar***
- b. *Informacion me shkrim që shpjegon arsyet e kërkesës për ndryshim të licencës. **Plotësuar.***
- c. *Vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër që vërteton kërkesën e të Licencuarit për ndryshimin specifik të Licencës. **Pa plotësuar***
Shoqëria TAP AG ALBANIA nuk e ka depozituar këtë dokument në ERE, por do t’i kërkohej që ta depozitonte atë pas fillimit të procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës nr. 436, seria TGN19, për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, me vendimin e bordit të ERE-s nr.15, datë 31.01.2019, për ndryshimin e afateve të kohëzgjatjes së saj nga 25 vite, në 30 vjet.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë TAP AG ALBANIA, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e tjera të interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI